

FONDI RAIFFEISEN INVEST EURO

**Pasqyrat financiare
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(me raportin e Audituesit të pavarur bashkëlidhur)**

Përmbajtja

Raporti i Audituesit të pavarur i-iii

Pasqyrat Financiare

Pasqyra e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse 1

Pasqyra e pozicionit financiar 2

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto 3

Pasqyra e flukseve monetare 4

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare 5-25

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për aksionarët e “Raiffeisen Invest” sh.a, Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, “Fondi Euro”, (këtu e më poshtë i referuar si “Fondi”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit më 31 dhjetor 2024 si edhe të performancës së saj financiare dhe parave për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet e Kontabilitetit (“SNRF”).

Baza e Opinionit

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (“SNA”-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar “Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare” të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (kodi “BKSNE”) dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me kodin BKSNE.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që paraqiten në raportin vjetor, përgatitur nga Drejtimi në përputhje me nenin 121 të ligjit nr. 56/2020 për “Sipërmarrjet e investimeve kolektive”, i ndryshuar, por nuk përfshin pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesit mbi këto pasqyra. Raporti vjetor parashikohet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit të pavarur. Opinionit ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim asnjë lloj opinionit në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë pasaktësi materiale me pasqyrat financiare, apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale. Kur të lexojmë Raportin Vjetor, nëse, në bazë të punës që kemi kryer, arrijmë në përfundimin se ka një anomali materiale të informacioneve të tjera, ne na kërkohet të raportojmë këtë fakt. Nuk kemi asgjë për të raportuar për këtë fakt.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Fondit për të vazhduar aktivitetin e tij në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Fondit dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveç se sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Fondit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi.

Nëse arrijmë në përfundimin se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit me reference në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit të audituesit tonë. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Bankës për vazhduar në vijimësi.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Fondit, ku përveç çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania shpk

Deloitte Audit Albania shpk

Rruga e Kavajës, ish parku i mallrave, Kompleksi Delijorgji, Godina H

Tirana, Albania

Numër unik identifikimi i subjektit (NUIS): L41709002H


Audituesi ligjor

Partner Angazhimi

Enida Cara

Tiranë, Shqipëri

28 mars 2025



Fondi Raiffeisen Invest Euro

Pasqyra e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 (të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Të ardhura			
Të ardhura nga interesat ose të ardhura të ngjashme	10	75,494	65,466
Të ardhura të tjera operative		3,407	4,034
Nryshime në vlerën e drejtë të instrumentave financiarë me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	12	83,129	153,604
		162,030	223,103
Shpenzime			
Humbje neto nga kursi i këmbimit	11	(193,452)	(315,775)
Tarifa e Shoqërisë së Administrimit	18	(45,239)	(44,962)
Shpenzime të tjera operative		(6,212)	(7,139)
		(244,903)	(367,876)
Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave		(82,872)	(144,773)

Shënimet e paraqitura në faqet 5 deri në 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi Raiffeisen Invest Euro

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
AKTIVET			
Paraja dhe ekuivalentë të saj	15	194,002	183,768
Llogari të arkëtueshme të tjera		-	97
Aktive financiare me VDNFH duke përjashtuar investimet në fonde të tjera të investimeve	13	2,684,635	2,295,063
Kuota në fonde investimit me vlerë të drejte nëpërmjet fitimit ose humbjes	14	1,081,545	844,003
TOTALI I AKTIVEVE		3,960,181	3,322,931
DETYRIMET			
Detyrime ndaj Shoqërisë së Administrimit		4,296	3,683
Të pagueshme për kërkesa tërheqje nga fondi		3,279	0
Detyrime të tjera	16	1,888	2,024
TOTALI I DETYRIMEVE		9,464	5,708
AKTIVET NETO QË I ATRIBUOHEN MBAJTËSVE TË KUOTAVE	17	3,950,718	3,317,223
Numri i kuotave të emetuara të Fondit		349,522	286,373
AKTIVET NETO PËR NJËSI NË LEK		11,303	11,584

Shënimet e paraqitura në faqet 5 deri në 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë miratuar më 28 Mars 2025 në emër të Fondit nga Këshilli i Administrimit të Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. dhe u firmosën nga:

Administratore e Përgjithshme

Edlira KONINI

**Zv.Administratore e Përgjithshme**

Alketa EMINI

Fondi Raiffeisen Invest Euro

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2024
(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Aktive neto që i atribuohen kontribuesve më 1 janar		3,317,223	3,829,980
Kontribute		1,776,538	565,977
Tërheqje		(1,060,171)	(933,959)
Rritja në aktivet neto që i atribuohen kontribuesve nga operacionet		4,033,590	3,461,998
Aktive neto (të detyrueshme nga)/të atribueshme ndaj kontribuesve	17	(82,872)	(144,773)
		3,950,718	3,317,225
NUMRI I KUOTAVE TË INVESTIMIT NË MIJË			
Të afuara/emetuara bazuar në kontribute		156,589	49,221
Të tërhequra nga mbajtësit e kuotave		(93,439)	(79,436)
RRITJE NË NUMRIN E KUOTAVE TË FONDIT		63,150	(30,215)

Shënimet e paraqitura në faqet 5 deri në 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi Raiffeisen Invest Eur

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

		2024	2023
Flukse monetare nga aktiviteti operacional	Shënime		
Ulja në aktivet neto që i atribuohet kontribuuesve		(82,872)	(144,773)
Rregullime për:			-
Humbje të perealizuara nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes	11	(13,340)	120,652
Të ardhura nga interesi		(75,494)	(65,466)
Shpenzime nga interesi		0	0
Humbjet nga këmbimi në para dhe ekuivalentët e saj		33,210	7,340
Mjete monetare neto nga aktiviteti operativ		(138,496)	(82,247)
Ndryshimet në:			
Instrumentat financiare me VDNFH		(395,703)	29,369
Kuota në fonde investimi		(247,755)	264,188
Të pagueshme ndaj shoqërisë administruese		612	691
Llogari të tjera të arkëtueshme		(97)	10
Detyrime të tjera		(136)	(272)
		(643,079)	293,986
Interes i arkëtuar		103,380	81,742
Interes i paguar			
Flukset e parasë të përdorura në aktivitetet operacionale		-539,699	375,728
Flukset monetare nga aktiviteti financues			
Kontribute të arketuara nga mbajtësit e kuotave		1,776,538	565,977
Kontribute të paguara ndaj mbajtësve të kuotave	17	(1,054,899)	(944,003)
Flukset monetare neto nga aktiviteti financues		721,639	(378,026)
Rritje/(Ulje) neto në flukset e parasë		43,444	(84,545)
Paraja dhe ekuivalentë të saj në fillim të vitit		183,768	275,651
Humbjet nga këmbimi në para dhe ekuivalentët e saj		(33,210)	(7,340)
Paraja dhe ekuivalentë të saj në fund të vitit	17	194,002	183,768

Shënimet e paraqitura në faqet 5 deri në 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi Raiffeisen Invest Eur

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Fondi i investimit Raiffeisen Invest Euro ("Fondi") është një fond investimi me ofertë publike i licensuar nga Autoriteti i Mbykqyrjes Financiare ("AMF") bazuar në ligjin nr. 10198 më datë 10 Dhjetor 2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe bazuar në vendimin nr. 180 më datë 13 Dhjetor 2011.

Aktivitetet investuese të fondit manaxhohen nga Raiffeisen INVEST sh.a – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive ("Shoqëria Adminstruese").

Objektivi i Fondit është që ti japë investitorit një kthim nga investimi në përputhje me një menaxhim të kujdesshëm, duke ruajtur nivelin e kapitalit dhe të likuiditetit të nevojshëm.

Te ardhurat nga investimi në Fond janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale dhe lidhen me të ardhurat kapitale te kontribuesve të cilat taten në normën 15%. Shoqëria administruese vepron si një agjent mbledhës në emër të Fondeve.

Fondi ofron investimin në kuota një grupi të gjerë investitorësh të cilët janë kryesisht individë.

Mbështetur në Ligjin nr. 56/2020, datë 20.06.2020, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka miratuar Bankën e Parë të Investimeve si bankë depozitare e Fondit të Investimit Raiffeisen Invest Euro ("Depozitari"). Shoqëria Administruese dhe Depozitari do të mbajnë aktivet, veprimet dhe regjistrimet e veta të ndara nga aktivet, veprimet dhe regjistrimet kontabël të Fondit të Investimit Raiffeisen Invest Euro.

Këshilli i Administrimit si organi qendror i Fondit përbëhet nga 7 anëtare si më poshtë:

Znj. Donalda GJORGA	Kryetar
Z. Peter ZILINEK	Zv.kryetar
Znj. Juela AHMETI	Anëtar
Znj. Elona LLACI	Anëtar
Znj. Gentjana CICERI	Anëtar
Znj. Edlira KONINI	Anëtar
Znj. Alketa EMINI	Anëtar

Administratorët:

Znj. Edlira KONINI	Administratore e Përgjithshme
Znj Alketa EMINI	Zv/Administratore e Përgjithshme

2. Bazat e përgatitjes

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare të janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"). Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 janë të miratuara nga Drejtimi i Fondit më datë 28 Mars 2025.

2.2. Parimi i vijimësisë

Ecuria e aktiveve të fondit dhe kthimi nga investimi

Sipas raportimit për vitin 2024 të mbyllur më 31 dhjetor 2024 pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, vlera neto e aktiveve të fondit Raiffeisen Euro është rritur me 26.05% krahasuar me vlerën e datës 31 dhjetor 2023, ndërsa numri i kuotave është rritur me 22.05% respektivisht, duke shënuar një normë totale kthimi për fundin prej 3.28% (31 dhjetor 2023: 5.29%).

Fondi Raiffeisen Invest Eur

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

2.2 Parimi I vijimësisë (vazhdim)

Ecuria e likuiditetit

Sipas raportimit për tremujorin e fundit të vitit 2023 për Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare tregon një nivel aktual më të lartë të rezervës së likuiditetit (Aktivet Likuide me Cilësi të Lartë ALCL) sesa kërkesat rregullore për likuiditet. Fondi konsiderohet të ketë një nivel të përshtatshëm likuiditeti për të përmbushur shlyerjet e investitorëve të tij si dhe detyrimet e tjera.

Fondi ka një nivel të Aseteve Likuide me Cilësi të Lartë (ALCL) që përbëhet nga mjete monetare ose aktive që mund të konvertohen në para me një humbje të vogël ose aspak të vlerës prej 62.60 %.

Prova e rezistencës

Shoqëria kryen provat e rezistencës për të përllogaritur likuiditetin e nevojshëm në rastin e skenarëve të përkeqësuar të tregut. Në vijim ajo ka përcaktuar raportin e likuiditetit në varësi të tërheqjeve neto që parashikohen gjatë një skenari të përkeqësuar për një periudhë javore për ekspozimet e mëdha dhe tremujore për ekspozimet mesatare. Në analizë merret parasysh dhe koha e nevojshme për shlyerjen e investimeve për të përballuar flukset e pritshme dalëse, duke filluar nga 3 ditë deri në 3 muaj.

Në bazë të supozimeve të skenarit të analizuar, vlerësohet se fondi mund të arrijë të përballojë veshtirësitë e mundshme të supozuara, duke qënë në përputhje edhe me kufizimet rregullore në lidhur me likuiditetin brenda afatit ligjor, nga ku vlerësohet se periudha minimale e mbulimit të flukseve është 3 muaj.

Bazuar në analizat e mësipërme, Drejtimi ka siguri të mjaftueshme se nuk ekzistojnë pasiguri materiale, që mund të ndikojnë në aftësinë e Fondit për të operuar sipas parimit të vijimësisë në të ardhmen e parashikuar. Për këtë arsye, përgatitja e pasqyrave financiare sipas parimit të vijimësisë konsiderohet e përshtatshme më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023.

3. Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek shqipëtar ("Lek"), e cila është monedha funksionale për Fondin. Fondi konsideron Lek-un si monedhën që përfaqëson më realisht efektin ekonomik të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve bazë. Leku është monedha në të cilën Fondi mat performancën dhe raporton rezultatet e tij dhe rrjedhimisht monedha funksionale dhe raportuese.

Ndërsa Euro është monedha në të cilën merren pagesa nga investitorët dhe monedha bazë e strategjisë së investimeve të Fondit. Kjo gjithashtu konsideron mjedisin konkurrues në të cilin është Fondi, krahasuar me fondet e tjera të investimit.

4. Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur bazuar në koston historike, përveç aktiveve financiare të investimeve në fonde të tjera investimi të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi i Fondit të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimet. Vlerësimet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

Gjykime dhe vlerësime

Informacioni për gjykimet e bëra në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektet më të rëndësishme në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë të përfshira në shënimin e mëposhtëm:

- Shënimi 3,8 – përcaktimi i monedhës funksionale
- Shënimi 9 – përcaktimi i vlerës së drejtë të instrumenteve financiare me të dhëna kryesive të pavrojtueshme
- Shënimi 14 – përfshirja me entitete të strukturuar të pakonsoliduara.

Fondi Raiffeisen Invest Eur

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

6. Standarde të reja dhe interpretime në publikim akoma jo në fuqi

Gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2024, shoqëria ka aplikuar një numër ndryshimesh në Standardet e Kontabilitetit SNRF të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB) të cilat janë efektive në mënyrë të detyrueshme për periudhën e raportimit që fillon më ose pas 1 janarit 2024. Zbatimi i tyre nuk ka patur ndonjë ndikim material në shpalosjet ose në shumat e raportuara në këto pasqyra financiare.

I. Standardet e reja dhe të ndryshuara të implementuara nga shoqëria

Standardet e mëposhtme të reja ose të ndryshuara kanë hyrë në fuqi gjatë vitit:

- *Ndryshimet në SNK 1* - Klasifikimi i Detyrimeve si Afatshkurtra ose Afatgjata dhe Detyrimet Afatgjata me Marrëveshje
- *Ndryshimet në SNK 7 dhe SNRF 7* - Marrëveshjet e Financimit të Furnitorëve
- *Ndryshimet në SNRF 16* - Detyrimi i Qirasë në një Shitje dhe Ridhënie me qira

II. Standardet dhe interpretimet e lëshuara, por ende jo efektive

Standardet e tjera, ndryshimet ose interpretimet që janë lëshuar, por ende nuk janë efektive dhe nuk janë zbatuar paraprakisht:

- *Ndryshimet në SNK 21* - Mungesa e Këmbyeshmërisë, datë efektive 1 janar 2025
- *Ndryshimet në SNRF 9 dhe SNRF 7* - Ndryshimet në klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare, datë efektive 1 janar 2026
- *Ndryshimet në SNRF 9 dhe SNRF 7* - Kontratat që i referohen energjisë elektrike të varur nga natyra, datë efektive 1 janar 2026
- *Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 7, SNRF 9, SNRF 10 dhe SNK 7* - Përmirësimet vjetore të Standardeve të Kontabilitetit të SNRF - Vëllimi 11, datë efektive 1 janar 2026
- *SNRF 18* - Paraqitja dhe Shpalosjet në Pasqyrat Financiare
- *SNRF 19* - Filialet pa Përgjegjësi Publike: Shpalosjet
- *Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28* - Shitja ose Kontributi i Aseteve midis një Investitori dhe Shoqërisë së Tij të Lidhur ose Sipërmarrjes së Përbashkët dhe ndryshime të tjera

Shoqëria nuk pret që zbatimi i standardeve të kontabilitetit të paraqitura më sipër të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të saj në periudhat e ardhshme.

Fondi Raiffeisen Invest Eur

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

7. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksioneve. Aktivët dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj në datën e raportimit janë rikonvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në atë datë. Aktivët dhe detyrimet jo-monetare të shprehura në monedha të huaja që maten me vlerën e drejtë, konvertohen në monedhën funksionale në kursin e këmbimit në datën kur përcaktohet vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë që maten në bazë të kostos historike në një monedhë të huaj janë përkthyer duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat në valutë të huaj që rrjedhin nga përkthimi njihen në fitim ose humbje.

b) Të ardhura nga interesi dhe të ardhura të ngjashme

Interesi njihet në bazë proporcionale kohore duke përdorur metodën efektive të interesit. Të ardhurat nga interesi përfshijnë interesa nga mjetet monetare dhe ekuivalente me to (depozita afatshkurtra). Të ardhurat nga aktivët financiarë me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes përfshijnë interesat nga letrat me vlerë.

c) Instrumenta Financiare

(i) Njohja dhe matja fillestare

Fondi njih aktivët dhe detyrimet financiare me VDNFH në datën e tregëtimit, e cila është data kur Fondi bëhet palë e provizionit kontraktual të instrumentit. Aktivët dhe detyrimet e tjera financiare njihen në datën kur ato krijohen.

Një aktiv financiar ose detyrim financiar, në njohjen fillestare do të matet me vlerën e drejtë të tij plus, në rastin e elementëve të përcaktuar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, koston e transaksionit që i ngarkohet drejtpërdrejt blerjes ose emetimit.

Fondi Raiffeisen Invest Eur

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

7. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

c) Instrumenta Financiare (vazhdim)

(ii) Klasifikimi dhe matja e mëparshme

Aktivet financiare

Në njohjen fillestare, aktivi financiar (me përjashtim të Mjeteve monetare, Depozitave, Marrveshjeve të Riblerjes (Repo)) klasifikohet si të matur me VDNFH. Aktivet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes fillestare, përveç nëse Fondi ndryshon modelin e saj të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare, në këtë rast të gjitha aktivet financiare të ndikuara riklasifikohen në ditën e parë të periudhës së parë raportuese pas ndryshimit në modelin e biznesit.

Mjetet monetare, depozitat dhe Marrëveshjet e Riblerjes (Repot) klasifikohen si të matura me kosto të amortizuar. Depozitat dhe Marrëveshjet e Riblerjes (Repot) nuk riklasifikohen pas njohjes fillestare të tyre, përveç rasteve kur Kompania ndryshon modelin e saj të biznesit për administrimin e aktiveve financiare, në të cilin rast të gjitha aktivet financiare të prekura riklasifikohen në ditën e parë të periudhës së parë raportuese pas ndryshimit në modelin e biznesit.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Fondi vlerëson objektivat e modeleve të biznesit sipas të cilave menaxhohet një aktiv në nivel portofoli sepse kjo reflekton mënyrën më të mirë sesi menaxhohet biznesi dhe si informacioni i paraqitet drejtimit.

Transferimi i aktiveve financiare me palë të treta me anë të transaksioneve që nuk i plotësojnë kushtet për çregjistrim, nuk konsiderohen shitje për këtë qëllim, në përputhje me njohjen në vazhdimësi të aktiveve të Fondit.

Fondi ka përcaktuar se ka një model biznesi që përfshin investimet në letrat me vlerë dhe investimet në fondet e investimeve të palistuara. Këto mjete financiare menaxhohen dhe performanca e tyre vlerësohet, në bazë të vlerë

Vlerësimi i modelit të biznesit (vazhdim)

së drejtë, me shitjet e shpeshta që ndodhin. Modeli i biznesit për Mjetet monetare, depozitat dhe Marrëveshjet e Riblerjes është 'held to collect'.

Për qëllim të këtij vlerësimi, 'principal' është vlera e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare. 'Interesi' është shpërblimi për vlerën në kohë të parasë dhe për rrezikun e kredisë të lidhur me shumën e principalit të pashlyer gjatë një periudhe kohore të caktuar, për rreziqet dhe kostot e tjera bazë të kreditimit (p.sh. rreziku i likuiditetit dhe kostot administrative), duke përfshirë gjithashtu marzhin e fitimit.

Për të vlerësuar nëse flukset monetare kontraktuale janë pagesa vetëm të principalit dhe interesit, Fondi merr parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse një aktiv financiar përmban një element kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve monetare kontraktuale në mënyrë të tillë që nuk plotëson kushtin.

Gjatë vlerësimit, Fondi konsideron:

- ngjarje të kushtëzuara që mund të ndryshojnë kohën dhe shumën e flukseve monetare;
- kushte që mund të ndryshojnë normën kontraktuale të interesit, përfshirë normat e ndryshueshme;
- parapagimet dhe kushtet e shtyrjes; dhe
- kushtet që kufizojnë pretendimet e Fondi për flukset monetare nga aktive të caktuara (tipare të pakthyeshme)

Nëse kushtet e një aktiviteti financiar modifikohen, Fondi vlerëson nëse flukset monetare të aktivitetit të modifikuar janë thelbësisht të ndryshme.

Nëse flukset e mjeteve monetare janë thelbësisht të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar origjinal konsiderohen se kanë skaduar. Në këtë rast, aktivi financiar fillestar çregjistrohet (shih (iii)) dhe një aktiv i ri financiar njihet me vlerën e drejtë.

Nëse flukset monetare të aktivitetit të modifikuar të mbajtura me kosto të amortizuar nuk janë thelbësisht të ndryshme, atëherë modifikimi nuk rezulton në çregjistrimin e aktivitetit financiar. Në këtë rast, Fondi rillogarit vlerën kontabël bruto të aktivitetit financiar dhe njeh shumën që rrjedh nga rregullimi i vlerës kontabël bruto si një fitim ose humbje modifikuese në fitim ose humbje. Nëse një modifikim i tillë kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit (shih (vii)), atëherë fitimi ose humbja paraqitet së bashku me humbjet nga zhvlerësimi.

Fondi Raiffeisen Invest Eur

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

7. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

c) Instrumenta Financiare (vazhdim)

Detyrimet financiare- Klasifikimi, matja e mëpasshme dhe fitimet dhe humbjet

Detyrimet financiare klasifikoheshin si të matura me koston e amortizuar dhe pas njohjes fillestare ato mateshin me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet e interesit dhe fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit dhe zhvlerësimi njiheshin në fitim ose humbje. Çdo fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit, njihet në fitim ose në humbje.

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe flukset e mjeteve monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast njihet, një detyrim i ri financiar i bazuar në kushtet e modifikuara, njihet me vlerën e drejtë. Diferenca midis vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar njihet në fitim ose humbje.

Nëse modifikimi i një detyrimi financiar nuk llogaritet si mosnjohje, atëherë kostoja e amortizuar e detyrimit rillogaritet duke skontuar flukset e modifikuara të mjeteve monetare me normën fillestare të interesit efektiv dhe fitimi ose humbja që rezultojnë njihet në fitim ose humbje.

(iii) Matja e vlerës së drejtë

‘Vlera e drejtë’ është çmimi që do të arkëtohej nga shitja e një aktivi ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes në një treg kryesor ose, në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm tek i cili Fondi ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një pasivi pasqyron rrezikun e tij të mosekzekutimit. Kur është e mundur, Shoqëria mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet “aktiv”, në qoftë se transaksionet për aktivin ose detyrimin ndodhin me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion mbi çmimet në vazhdimësi.

Nëse nuk disponohet një kuotim çmimi në një treg aktiv, atëherë Shoqëria përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e të dhënave të vrojtueshme dhe minimizojnë përdorimin e të dhënave jo të vrojtueshme. Teknika e zgjedhur përmbledh të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të marrin në konsideratë për përcaktimin e çmimit të një transaksioni- dmth. Vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë.

Nëse Fondi përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk dëshmohet as nga një çmim i kuotuar në treg për një aktiv apo detyrim identik dhe as i bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet e vrojtueshme, atëherë instrumenti financiar fillimisht matet me vlerë të drejtë, përshtatur për të evidentuar dallimin midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, ky dallim njihet në fitim ose humbje mbi një bazë të përshtatshme mbi jetën e instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi mbështetet plotësisht nga të dhënat e vëzhgueshme të tregut ose transaksioni është mbyllur. Fondi njih transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë si në fund të periudhës raportuese, gjatë së cilës ka ndodhur ndryshimi.

d) Investimet në letrat me vlerë

Investimet në letra me vlerë përfshijnë bono thesari të matura në vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Referohu Shënimit 7 (c).

e) Mjetet Monetare dhe ekuivalentet e saj

Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë aktive financiare mjaft likuidë me maturitet tre muaj ose më pak nga data e blerjes, të cilat janë subjekt i një rreziku jo të rëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e drejtë, dhe përdoren nga Fondi për menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet Monetare dhe ekuivalentet e saj mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

f) Llogari të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerë të drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar dhe maten me koston e tyre të amortizuar duke zbritur humbjet nga zhverësimet.

Fondi Raiffeisen Invest Eur

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

7. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

g) Të pagueshme për kërkesa tërheqje nga fondi

Të pagueshme për kërkesa tërheqje nga fondi maten me koston e tyre të amortizuar. Fondi emeton kuota të shlyeshme, me kërkesë të investitorit. Çdo investitor që ka bërë shlyerje të kuotave të tij, mund të ri-investojë në Fond nëpërmjet depozitimit të mjeteve monetare ekuivalente me vlerën e kuotave të kërkuara. Kuotat janë të shlyeshme çdo ditë. Në momentin e kërkesës për shlyerje, kuotat që do të shlyhen mbarten në vlerën e shlyerjes si detyrim i pagueshëm në pasqyrën e pozicionit financiar të Fondit. Çmimi i kuotave të shlyeshme bazohet në vlerën neto të aktivitetit të Fondit për njësi në kohën kur është bërë një kërkesë e vlefshme për shlyerje.

h) Vlera neto e aktiveve

Vlera neto e aktiveve është e barabartë me vlerën totale të aktiveve neto minus detyrimet e Fondit. Vlera e kuotës së Fondit është e barabartë me vlerën neto të aktiveve pjesëtuar me numrin total të kuotave në datën e raportimit. Bazuar në politikat e Fondit, vlera kuotes në nisjen e Fondit ishte e barabartë me Euro 100.

i) Tarifa e Shoqërisë Administruese

Fondi duhet t'i paguajë Shoqërisë së Administrimit një tarifë prej 1.30% në vit (2021 -1.30% duke filluar nga 25 Nëntor 2021 dhe deri më Nëntor 24: 1.50%) të vlerës së aktiveve neto, si shpenzim i cili llogaritet në baza ditore.

j) Fitimi/humbja e porealizuar

Fitimi ose humbja e porealizuar përfaqëson diferencën midis vlerës kontabël të një instrumenti financiar në fillim të periudhës, ose çmimit të transaksionit nëse është blerë në periudhën aktuale të raportimit, dhe vlerës së tij kontabël në fund të periudhës raportuese.

k) Fitimi/humbja e realizuar

Fitimi ose humbja e porealizuar përfaqëson diferencën midis vlerës kontabël të një instrumenti financiar në fillim të periudhës, ose çmimit të transaksionit nëse është blerë në periudhën aktuale të raportimit, dhe vlerës së tij kontabël në fund të periudhës raportuese. Keto diferenca transferohet në fitim/ humbje për periudhën.

8. Administrimi i rrezikut financiar

(a) Pamje e përgjithshme

Aktivitetet e Fondit e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare: rrezikut të tregut (duke përfshirë rrezikun e këmbimit valutor, rrezikun e normës së interesit dhe rreziqe të tjera të çmimeve), rrezikut të kredisë dhe rrezikut të likuiditetit. Fondi është i ekspozuar edhe ndaj rreziqeve operacionale të tilla si rreziku i kujdestarisë. Rreziku i kujdestarisë është rreziku i humbjes së letrave me vlerë të mbajtura në kujdestari të shkaktuar nga neglizhenca e kujdestarit. Edhe pse është vendosur një kuadër i përshtatshëm ligjor që eliminon rrezikun e humbjes së vlerës së letrave me vlerë të mbajtura nga kujdestari, në rast të dështimit të saj, aftësia e Fondit për të transferuar letrat me vlerë mund të dëmtohet përkohësisht. Programi i përgjithshëm i menaxhimit të rrezikut të Fondit kërkon të maksimizojë kthimin që vjen nga niveli i rrezikut për të cilat Fondi është i ekspozuar dhe kërkon për të minimizuar efektet e mundshme negative mbi performancën financiare të Fondit.

Bazuar në Ligjin Nr. 10198, datë 10 Dhjetor 2009 "Per Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive", Shoqëria Administruese ka në strukturat e saj një Njësi Menaxhimi të Rrezikut, përgjegjëse për menaxhimin e rrezikut dhe raportimin e tij tek Bordi i Administrimit. Politikat e menaxhimit të rrezikut të Fondit krijohen për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat ballafaqohet institucioni financiar, për të vendosur kufizimet dhe kontrollat e përshtatshme të rrezikut dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Shoqërisë, përmes standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre

Fondi Raiffeisen Invest Eur

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

8. Administrimi i rrezikut financiar

(b) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Fondit nëse një klient ose një palë tjetër e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale, pjesërisht ose plotësisht gjë që sjell efekt negativ në aktivevet e Fondit. Bordi i Administrimit të Fondit ka deleguar përgjegjësinë për menaxhimin e rrezikut të kredisë për Drejtimin, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezikut të kredisë të Fondit. Investimet e Fondit janë në bono thesari dhe obligacione të Qeverisë Shqiptare dhe për këtë arsye Fondi ekspozohet vetëm ndaj rrezikut të kredisë të qeverisë shqiptare. Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson ekspozimin maksimal të kredisë. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë në 31 dhjetor 2024 është shuma e mbartur e aktiveve financiare si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Aktive financiare me VDNFH duke përjashtuar investimet në fonde të tjera të investimeve	2,684,635	2,295,063
Kuota në fonde investimi	1,081,545	844,003
Paraja dhe ekuivalentë të saj	194,002	183,768
Totali	3,960,181	3,322,834

Cilësia e kredisë së aktiveve financiare është si vijon:

	2024	2023
Qeveria Shqipëtare BB-	1,487,154.00	1,580,074
Qeveri të tjera ne grade investimi	617,667	250,200
Obligacione te organizatave nderkombetare me grade investimi	100,469	-
Obligacione të korporatave AAA -AA	391,671	-
Obligacione te korporatave A-BBB-	87,673	464,789
Kuota në fonde investimi	1,081,545	844,003
Mjete Monetare dhe ekuivalente me to	194,002	183,768
Vlera kontabël	3,960,181	3,322,834

Mjete monetare dhe ekuivalentët e saj janë të mbajtura në banka vendase, të cilat janë të parankuara.

Kuotat në fonde investimi janë të vendosura kryesisht në Austri dhe janë të lidhura me grupin “Raiffeisen Bank International” me rating A1 sipas Moody’s për vitin 2024.

Mjete monetare dhe ekuivalentët e saj

Mjete monetare dhe ekuivalentët e saj mbahen në bankat tregtare në Shqipëri. Fondi zbaton një model të humbjeve të pritshme dhe paraqet ekspozimet me maturim afatshkurtër në përcaktimin e zhvlerësimit e pasasë dhe ekuivalentëve të saj.

Fondi nuk ka njohur humbje zhvlerësimi më dhe gjatë vitit 2024 për mjetet monetare dhe depozitat afatshkurta. Vlera e humbjeve në zhvlerësime është imateriale në pasqyrat financiare.

Investime në letra me vlerë

Rreziku i kredisë së portofolit të letrave me vlerë të investimit vlerësohet në bazë të të dhënave historike dhe vlerësimit të aftësisë së emetuesve të ndryshëm për të përmbushur detyrimet e saj kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare në afatin e shkurtër.

Të dhënat, supozimet dhe teknikat e përdorura për përllogaritjen e zhvlerësimit

Rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë

Për përcaktimin nëse rreziku i mospagimit të vlerës së investuar të një instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, Shoqëria konsideron informacione të mbështetura dhe të arsyeshme, që janë të disponueshme pa kosto ose përpjekje të panevojshme. Kjo përfshin informacione dhe analiza sasiore dhe cilësore, bazuar në përvojën historike të Shoqërisë dhe vlerësimet e specialistëve të rrezikut të kreditit si dhe duke përfshirë informacione mbi të ardhmen.

Fondi Raiffeisen Invest Eur

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë (vazhdim)

Për ekspozimet ndaj qeverisë shqiptare, rreziku i kredisë konsiderohet të jetë rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare nëse ka vonesë prej 30 ditësh ose më shumë në shlyerjen e një detyrimi ndaj Shoqërisë.

Fondi konsideroi një instrument financiar që ka pasur një rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë kur një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme sasiore, cilësore ose kthyes janë përmbushur.

Fondi monitoron efektshmërinë e kriterëve të përdorura për të identifikuar rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë, nëpërmjet rishikimeve të rregullta për të konfirmuar se kriteret janë në gjendje të identifikojnë rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë para se një ekspozim të jetë në dështim.

Përkufizimi i dështimit

Shoqëria konsideron që një aktiv financiar ka dështuar kur:

- debitori nuk ka gjasa të paguajë detyrimet e tij të plota ndaj Shoqërisë, pa qenë nevoja për veprime nga Shoqëria të tilla si realizimi i aktive të lëna si kolateral (nëse ka ndonjë të tillë); ose
- debitori është në vonesë prej më shumë se 90 ditësh për ndonjë ekspozim material ndaj Shoqërisë.

Në vlerësimin nëse një huamarrës është në dështim, Shoqëria konsideron tregues:

- cilësorë – p.sh. shkeljet e kushteve financiare të kontratës;
- sasiore- p.sh. vonesat në pagesë dhe mospagimi i ndonjë detyrimi tjetër nga i njëjti huamarrës; dhe

Të dhënat e përdorura në vlerësimin nëse një instrument financiar ka dështuar dhe rëndësia e tyre mund të ndryshojë me kalimin e kohës për të pasqyruar ndryshimet në rrethana

Mjetet financiare të modifikuara

Kushtet kontraktuale të një aktivi financiar mund të modifikohen për arsye të ndryshme, duke përfshirë ndryshimin e kushteve të tregut dhe faktorë të tjerë që nuk lidhen me ndonjë përkeqësim aktual ose potencial të cilësisë së kreditit të kundërpartisë. Një aktiv ekzistues, kushtet e të cilit janë modifikuar mund të çregjistrohet dhe aktivi i rinegociuar njihet si aktiv i ri me vlerë të drejtë në përputhje me politikën kontabël të përcaktuar në Shënimin 7(c)(v).

Matja e HPK

Mjetet Monetare dhe Ekuivalente me to

Fondi zbaton një model 12-mujor të humbjeve të pritshme dhe paraqet ekspozimet me maturim afatshkurtër në përcaktimin e zhvlerësimit e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e saj.

Fondi nuk ka njohur humbje zhvlerësimi më dhe për 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023.

Fondi Raiffeisen Invest Eur

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

8. Administrimi i Rrezikur Financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Fondi mund të mos jetë në gjendje të gjenerojë burime të mjaftueshme monetare për të shlyer plotësisht detyrimet ose mund t'i shlyejë në kushte të cilat janë materialisht jo të favorshme. Fondi mund të investoj periodikisht në letra me vlerë që tregtohen mbi bankak. Politika e Fondit në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa të jetë e mundur, se gjithmonë do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet kur është e nevojshme, nën kushte normale dhe tensioni, duke përfshirë edhe shlyerjet e vleruara të kuotave, pa shkakuar papranueshmëri humbje ose duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të Fondit. Fondi ka aftësinë të marrë hua në terma afatshkurtër për të arritur marrëveshjen, pas miratimit nga AMF dhe deri në një limit të caktuar të përcaktuar nga ligji. Raste të tilla huamarrjesh nuk ka pasur gjatë vitit ushritimor. Për të menaxhuar likuiditetin e përgjithshëm të Fondit, Shoqëria Administruese gjithashtu ka aftësinë të pezullojë rimbursimet nëse kjo konsiderohet të jetë në interesin më të mirë të të gjithë zotëruesve të njësisë. Në mungesë të detyrimeve financiare, Shoqëria administruese monitoron rrezikun e likuiditetit bazuar në flukse kontraktuale të skontuara të parasë. Tabela më poshtë analizon aktivet dhe detyrimet e Fondit në grupimet përkatëse të maturimit në bazë të periudhës së mbetur nga data e pasqyrës së pozicionit financiar deri në datën e maturimit kontraktual. Shumat në tabela janë flukset monetare kontraktuale të skontuara më 31 Dhjetor 2024 dhe 2023:

31 dhjetor 2024	Deri 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
Aktivët						
Investment in other investment funds at FVTPL	1,081,545	-	-	-	-	1,081,545
Financial assets at FVTPL excluding investment in other investment funds	-	-	29,314	83,013	2,535,119	2,647,446
Paraja dhe ekuivalentë të parasë	194,002	-	-	-	-	194,002
Llogari të tjera të arkëtueshme	0	-	-	-	-	-
Totali	1,275,546	0	29,314	83,013	2,535,119	3,922,992
Detyrimet						
Të pagueshme ndaj Shoqërisë së Administrimit	4,296	-	-	-	-	4,296
Të pagueshme ndaj mbajtësve të kuotave	3,279	-	-	-	-	3,279
Detyrime të tjera	1,888	-	-	-	-	1,888
Aktive neto të atrueshme ndaj mbajtësve të kuotave	3,950,718	-	-	-	-	3,950,718
Totali	3,960,181	-	-	-	-	3,960,181
Rreziku i likuiditetit	(2,684,635)	0	29,314	83,013	2,535,119	(37,189)
Akumulimi	(2,684,635)	(2,684,635)	(2,655,321)	(2,572,308)	(37,189)	(37,189)

Fondi Raiffeisen Invest Eur

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

*(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***Administrimi i Rrezikut financiar (vazhdim)****(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

31 dhjetor 2023	Deri 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
Aktivët						
Investment in other investment funds at FVTPL	844,003	-	-	-	-	844,003
Financial assets at FVTPL excluding investment in other investment funds	-	98,454	679,057	101,968	1,383,538	2,263,016
Paraja dhe ekuivalentë të parasë	183,739	-	-	-	-	183,739
Llogari të tjera të arkëtueshme	97	-	-	-	-	97
Totali	1,027,840	98,454	679,057	101,968	1,383,538	3,290,856
Detyrimet						
Të pagueshme ndaj Shoqërisë së Administrimit	3,683	-	-	-	-	3,683
Të pagueshme ndaj mbajtësve të kuotave	-	-	-	-	-	-
Detyrime të tjera	2,024	-	-	-	-	2,024
Aktive neto të atrueshme ndaj mbajtësve të kuotave	3,317,223	-	-	-	-	3,317,223
Totali	3,322,931	-	-	-	-	3,322,931
Rreziku i likuiditetit	(2,295,091)	98454.0879	679,057	101,968	1,383,538	(32,075)
Akumulimi	(2,295,091)	(2,196,637)	(1,517,581)	(1,415,613)	(32,075)	

Aktivët neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave përfaqësojnë të gjithë vlerën neto të aktiveve të fondit. Në llogaritjen e hendekut të likuiditetit supozohet se të gjithë mbajtësit e kuotave do të shlyejnë njësitë në të njëjtën kohë, gjë që ka shumë pak gjasë. Tërheqja maksimale e fondit është -14.15%.

Fondi Raiffeisen Invest Eur

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(d) Rreziku i tregut**

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut do të ndikojnë në të ardhurat e fondit ose në vlerën e zotërimeve të instrumenteve financiare. Qëllimi i menaxhimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin në rrezik.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Fondi është i ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit për shkak se ka transaksione në monedhë të huaj, përveç monedhës bazë të pasqyrave financiare (monedha Lek).

Më 31 dhjetor 2024, nuk ka aktive apo detyrime materiale të shprehura në monedha të ndryshme nga Euro:

Lek	31 dhjetor 2024		31 dhjetor 2023	
	Kursi mesatar	Në datën e raportimit	Kursi mesatar	Në datën e raportimit
EUR	100.70	98.15	108.75	103.88
USD	93.04	94.26	100.62	93.94

Ekspozimi i kompanisë ndaj rrezikut të valutës së huaj më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 ishte si më poshtë

31 dhjetor 2024	Balanca e mbartut	EUR	ALL	USD
		(shuma e përkthyer në mijë LEK)		
Paraja dhe ekuivalentë të saj	194,002	194,002	-	-
Aktive financiare me VDNFH duke përjashtuar investimet në fonde të tjera të investimeve	2,684,635	2,684,635	-	-
Kuota në fonde investimit me vlerë të drejte nëpërmjet fitimit ose humbjes	1,081,545	1,081,545	-	-
Detyrime ndaj Shoqërisë së Administrimit	(4,296)	(4,296)	-	-
Të pagueshme për kërkesa tërheqje nga fondi	(3,279)	(3,279)	-	-
Ekspozimi Neto	3,952,606	3,952,606	-	-
		(shuma e përkthyer në mijë LEK)		
31 dhjetor 2023	Balanca e mbartur	EUR	LEK	USD
Mjete monetare dhe ekuivalentët me to	183,768	183,768	-	-
Aktive financiare me VDNFH duke përjashtuar investimet në fonde të tjera të investimeve	2,295,063	2,295,063	-	-
Investimit në fonde të tjera me VDNFH	844,003	844,003	-	-
Detyrime ndaj Shoqërisë së Administrimit	(3,683)	(3,683)	-	-
Të pagueshme për kërkesa tërheqje nga fondi	-	-	-	-
Ekspozimi Neto	3,319,150	3,319,150	-	-

Fondi Raiffeisen Invest Eur

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

d) Rreziku I tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit

Rreziku kryesor për të cilin janë ekspozuar portfolet tregtare është rreziku i humbjes nga luhatjet në flukset e ardhshme të mjeteve monetare ose vlerat e drejta të instrumentit financiar për shkak të një ndryshimi në normat e interesit të tregut (Vlerat aktuale neto të aktiveve dhe detyrimeve). Rreziku i normës së interesit menaxhohet kryesisht përmes monitorimit të mangësive të normave të interesit. Menaxhimi i rrezikut të normës së interesit kundrejt mangësive të normave të interesit shoqërohet nga monitorimi i ndjeshmërisë së aktiveve dhe detyrimeve financiare të Fondot kundrejt skenarëve të ndryshëm standard dhe jo standard. Skenarët standard të cilët shqyrtohen në interval të rregullt përshijnë një rritje ose rënie prej 100 pbs në të gjitha kurbat e kthimeve.

Një analizë e ndjeshmërisë së Fondit nga një rritje apo rënie e normave të interesit të tregut (duke supozuar mungesën e lëvizje simetrike për kurbat e kthimeve dhe një pozicion konstant financiar) është si më poshtë:

2024		
Normat e Interesit	Rënie 100 pbs	Rritje 100 pbs
Efekt i Fitimit/(Humbjes)	125,538	(125,538)
2023		
Normat e Interesit	Rënie 100 pbs	Rritje 100 pbs
Efekt i Fitimit/(Humbjes)	87,393	(87,393)

(e) Administrimi i rrezikut të kapitalit

Kapitali i Fondit përfaqësohet nga aktivet neto që i atribuohen mbajtësit të kuotave. Shuma e aktivitetit neto që i atribuohet mbajtësit të kuotave mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme në baza ditore, pasi Fondi i nënshtrohet investimeve dhe tërheqjeve ditore sipas gjykimit të mbajtësit të kuotës. Objektivi i Fondit përsa i përket menaxhimit të kapitalit është të ruajë vazhdimësinë e tij me qëllim sigurimin e kthimit për mbajtësin e kuotës, sigurimin e përfitimeve për palët e tjera dhe ruajtjen e një bazë të fortë kapitali për të mbështetur zhvillimin e aktiviteteve të investimeve të Fondit. Për të ruajtur strukturën e kapitalit, politika e Fondit do të performoje si më poshtë:

- Monitorimi i nivelit të hyrjeve dhe tërheqjeve ditore në raport me situatën e likuiditetit duhet të mundësojë likuidimin e kërkesave brenda 7 ditëve nga dita e kërkesës së vlefshme.
- Shlyerja dhe emetimi i kuotave të reja duhet kryer në përputhje me ligjin dhe prospektin e Fondit. Kjo përfshin aftësinë për të kufizuar shlyerjet dhe për të kërkuar një minimum investimi në Fond. Administratorët e Shoqërisë Administruese monitorojnë kapitalin në bazë të vlerës së aktiveve neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave.

(i) *Strategjia e investimit*

Strategjia e investimeve të aktiveve të Fondit Raiffeisen Euro mbështetet në ligjin nr. 10198 “Per Fondet e Investimit Kolektiv” dhe rregulloret e dala në zbatim të tij, si dhe në politikën e brendshme të investimit të Shoqërisë Administruese, propozuar nga Komiteti i Investimit dhe miratuar nga Keshilli i Administrimit i Shoqërisë Administruese.

(ii) *Kuadri ligjor*

Në lidhje me investimet e aktiveve të Fondit, Raiffeisen Euro nën administrimin e Raiffeisen INVEST-Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. i përmbahet ligjit nr. 56/2020, datë 20 qershor 2020 “Për Sipërmarrjet e përbashkëta të investimit” dhe prospektin të Fondit.

Fondi Raiffeisen Invest Eur

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

e) Administrimi i rrezikut të kapitalit (vazhdim)

(iii) Investimet e lejuara

Sipas rregullores, aktivet e Fondit mund të investohen vetëm në instrumentet e mëposhtëm::

- tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë, që tregtohen në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë, në një shtet të Bashkimit European apo në çdo shtet tjetër të lejuar nga AMF-ja;
- kuota të fondeve të investimit apo aksione të Fondeve të investimit, të licencuara sipas ligjit nr.10198, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe nga kuota ose aksione të sipërmarrjeve kolektive të investimit, të licencuara në përputhje me standardet e Bashkimit European;
- depozita në institucione kreditimi, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, në një nga shtetet anëtare të BE-së ose në çdo shtet të lejuar nga AMF-ja, të cilat mund të tërhiqen menjëherë ose që kanë afat maturimi jo më shumë se 12 muaj;
- instrumente financiare derivative;
- instrumente të tjera të tregut të parasë.

Shoqëria administruese duhet të respektojë kufizimet e investimit të parashikuara në Ligjin nr.10198, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe ato të parashikuara në politikën e brendshme për menaxhimin e rrezikut.

Kufizimet e investimit dhe kufiri i lejuar

Fondi nuk mund të investojë më shumë se 20% të aktiveve të saj në depozita në të njëjtin institucion .

Fondi nuk mund të investojë më shumë se 5% të aktiveve të saj në tituj dhe instrumente të tregut të parasë të një emetuesi të vetëm.

Kufiri 5%, mund të rritet deri në:

- a) 10%. Në këtë rast, vlera totale e titujve ose instrumenteve të tregut të parasë, që mban Fondi te disa emetues, ku për secilin ka investuar mbi 5% të aktiveveve, nuk duhet të tejkalojë 40% të vlerës totale të aktivevetë fondit;
- b) 35% në rastin e titujve dhe të instrumenteve të tregut të parasë, të emetuara ose të garantuara nga qeveria dhe autoritetet vendore të Republikës së Shqipërisë, shteteve të Bashkimit European, shteteve të tjera të lejuara nga AMF-ja, ose nga organizma publikë ndërkombëtarë, në të cilët bëjnë pjesë një ose më shumë shtete të Bashkimit European;
- c) 100% me miratimin e AMF-së, nëse disa nga kushtet e përcaktuara nga Ligji “Mbi sipërmarrjet e investimeve kolektive” përmbushen.
- d) 25% në rastin e disa obligacioneve të veçanta, të emetuara nga institucionet kredituese të licencuara, të cilat e kanë selinë e regjistruar në Republikën e Shqipërisë, apo në një shtet të Bashkimit European apo të lejuara nga AMF-ja. Kur Fondi investon më shumë se 5% të aktivevenë këto lloj obligacionesh të emetuara nga një emetues i vetëm, atëherë vlera totale e këtij investimi nuk tejkalon 80% të vlerës totale të aktiveve të Fondit;

Fondi mund të investojë deri në 30% të aktivevetë tij në kuota apo aksione të një forme tjetër të sipërmarrjeve të investimeve kolektive. Shoqëria Administruese i menaxhon aktivet e Fondit sipas parimit të sigurisë afatgjatë dhe të një kthimi të përshtatshëm nga investimi, duke ruajtur një raport optimal mes rritjes së kapitalit dhe rrezikut të marrë përsipër. Objektivat afatgjatë për shpërndarjen e aktiveve të Fondit janë si më poshtë:

Fondi Raiffeisen Invest Eur

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

e) Administrimi i rrezikut të kapitalit (vazhdim)

(iii) Investimet e lejuara (vazhdim)

Klasa	Objektivi
-Tituj të emetuar dhe garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe autoritetet vendore shqiptare	40%
-Tituj të emetuar dhe garantuar nga shtete dhe autoritete të Bashkimit Europian, nga organizma publike ndërkombëtare ose nga çdo shtet i lejuar nga AMF-ja	8%
-Depozita bankare ose certifikata depozite	5%
-Kuota në Sipërmarrjeve të tjera Investimesh Kolektive	25%
-Tituj të transferueshëm dhe instrumente të tjerë financiarë të borxhit që tregëtohen në tregje të rregulluara ose burse titujsh në Republikën e Shqipërisë, në një shtet të Bashkimit Europian apo në çdo shtet tjetër të lejuar nga AMF-ja	22 %

Këto objektiva janë orientuese dhe mund të ndryshojnë në varësi të kushteve të tregut dhe politikës së investimit.

Politika e brendshme e investimeve të Fondit

Rreziku në investime ndërmerret vetëm nga anëtarë të Fondit dhe jo nga Shoqeria Administruese. Për të minimizuar këtë rrezik, Shoqeria Administruese ka përfshirë në strukturën e saj organizative, Komitetin e Investimeve, i cili propozon politikat për alokimin e pasurive dhe investimeve dhe një Njësi për Menaxhimin e rrezikut e cila kryen kontrollin sasior dhe cilësor të gjitha rreziqeve të lidhura me Fondin. Nuk lejohen të gjitha ato investimet, norma e kthimit e të cilave, është nën nivelin e tregut, sepse kjo do të rrezikojë ekuilibrin e lidhjes investime - rrezik.

Pasqyra e strukturës së investimeve më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 paraqitet si më poshtë:

	Vlera në datën e raportimit	Si % të totalit të aktiveve të fondi
Obligacione Qeveritare	2,205,290	56%
Obligacione të korporatave	479,345	12%
Kuota në fonde investimit	1,081,545	27%
Paraja dhe ekuivalentë të saj	194,002	5%
31 dhjetor 2024	3,960,181	100%

	Vlera në datën e raportimit	Si % të totalit të aktiveve të fondit
Obligacione Qeveritare	1,830,274	55%
Obligacione të korporatave	464,789	14%
Kuota në fonde investimit	844,003	25%
Paraja dhe ekuivalentë të saj	183,768	6%
31 dhjetor 2023	3,322,834	100%

Fondi Raiffeisen Invest Eur

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

9. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të tregtuara në tregje aktive bazohet tek çmimet e kuotuar të tregut ose në çmimet e shitësit. Vlera e drejtë e instrumenteve të tjera financiare përcaktohet përmes teknikave të vlerësimit. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e skontimit të flukseve monetare, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ka çmime tregu dhe modelet e vlerësimit.

Qëllimi i teknikave të vlerësimit është të arrijë një matje me vlerën e drejtë që pasqyron çmimin që do të merret për të shitur aktivin ose paguar për të transferuar detyrimin në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

Fondi e mat vlerën e drejtë duke përdorur Nivelin 1 dhe Nivelin 2 të hierarkisë së vlerës së drejtë, i cili reflekton rëndësinë e elementëve të përdorur në realizimin e vlerësimit, që shpjegohet si më poshtë:

- **Niveli 1:** Të dhënat per Nivelin 1 janë çmimet e kuotuar në treg për aktive dhe detyrime të ngjashme që entiteti mund të aksesojë në datën e matjes. Çmimi i kuotuar në treg përfaqëson dëshminë me të besueshme të vlerës së drejtë dhe përdoret pa u axhustuar për të matur vlerën e drejtë, me disa përjashtime.
- **Niveli 2:** Teknikat e vlerësimit të bazuara në elementet e vëzhgueshëm, në mënyrë direkte ose jo direkte. Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuar nëpërmjet çmimeve të instrumenteve të ngjashëm të kuotuar në tregje aktive; çmimet e kuotuar të instrumenteve të njëjta ose të ngjashme në tregje jo shumë aktive; ose teknika të tjera vlerësimi, ku të gjithë elementet e rëndësishme vëzhgohen në mënyrë direkte ose jo direkte nga të dhënat e tregut.

Vlerat e drejta të aktiveve dhe detyrimeve financiare që shiten në tregje aktive bazohen në çmime tregu. Si rezultat, ato paraqiten në vlera të drejta në nivelin 1. Për instrumente financiare që tregtohen jo rregullisht and kanë transparencë të ulët të çmimeve, vlera e drejtë është më subjektive and kërkon gjykim bazuar në likuiditet, përqendrim, pasiguri të faktorëve të tregut, supozime të çmimeve dhe risqe të tjera që ndikojnë instrumentin specifik.

Mjete Monetare dhe ekuivalente me to dhe depozita

Mjete Monetare dhe ekuivalente me to përfshin paratë në dorë, llogarite rrjedhëse me bankat rezidete. Duke qenë se këto bilanc janë afatshkurtra, vlera e tyre e drejtë konsiderohet të jetë e barabartë me vlerën e tyre kontabël.

Investimet në letra me vlerë

Investimet në letra me vlerë përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverisë. Vlera e drejtë e tyre llogaritet duke përdorur modelin e flukseve të skontuara të parave bazuar në normën e brendshme aktuale të kthimit e përshtatshme për maturitetin e mbetur. Investimet mbahen në vlerë të drejte.

Kuota në fonde të tjera investimi

Vlera e drejtë e ktyre investimeve përcaktohet duke përdorur çmimet ditore të kuotuar te publikuara rregullisht nga Fondet respektive të Investimit.

Tabela e mëposhtme analizon në kuadër të hierarkisë së vlerës së drejtë aktivet financiare të Fondit (në bazë të klasës) i matur me vlerën e drejtë më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023.

Fondi Raiffeisen Invest Eur

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

9. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare (vazhdim)

31 dhjetor 2024	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Obligacione te qeverise Shqipëtare	-	1,487,154	-	1,487,154
Obligacione te qeverive te tjera	-	718,136	-	718,136
Obligacione te korporatave	-	479,345	-	479,345
Fonde Investimi	1,081,545	-	-	1,081,545
	1,081,545	2,684,635	-	3,766,180

31 dhjetor 2023	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Obligacione te qeverise Shqipëtare	-	1,580,074	-	1,580,074
Obligacione te qeverive te tjera	-	250,200	-	250,200
Obligacione te korporatave	-	464,789	-	464,789
Fonde Investimi	844,003	-	-	844,003
	844,003	2,295,063	-	3,139,066

Të gjitha matjet e vlerës së drejtë të publikuara janë matje te vlerës së drejtë periodike.

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Aktive financiare me VDNFH duke përjashtuar investimet në fonde të tjera të investimeve	2,684,635	2,295,063
Kuota në fonde investimi	1,081,545	844,003
Totali	3,766,180	3,139,066

Vlerësimet janë përgatitur dhe shqyrtuar në baza të rregullta nga vlerësimi i Menaxherit të rrezikut që raporton dhe i jep rekomandime shoqërisë administruese në bazë mujore, në përputhje me vlerësimet mujore që janë dhënë për investitorët. Menaxheri i rrezikut konsideron përshtatshmërinë e modelit të vlerësimit, të dhënat hyrëse kryesore si dhe rezultatin e vlerësimit duke përdorur metoda të ndryshme të vlerësimit dhe teknika përgjithësisht të njohura si standarde në kuadër të industrisë. Teknika e vlerësimit është zgjedhur dhe kalibruar në blerjen e titujve themelore të portofolit. Në përcaktimin e përshtatshmërisë të teknikës së zgjedhur të vlerësimit, Menaxheri i rrezikut mund të kryejë testimin përsëri duke marrë në konsideratë rezultatet aktuale të modeleve të ndryshme dhe se si ata historikisht janë në një linjë me transaksionet aktuale të tregut.

Përveç kësaj, Banka e Kujdestarisë është përgjegjëse për rishikimin e rivlerësimeve përmes një procedure të konfirmimit ditor.

Investimet në fonde të tjera në vlerë të drejtë nëpërmjet kuotave të fitim-humbjeve do të vlerësohen në vlerën e aktiveveneto për kuotë të entitetit respektiv, sipas publikimit me domethënie vlera e kuotës e disponueshme në ditën e vlerësimit. Në rast se vlera neto nuk është publikuar, ose nuk është disponueshme në ditën e vlerësimit, vlera e drejtë e kuotës që shërben si bazë kalkulimi do të jetë çmimi I fundit I publikuar për atë entitet nga kompania administrative përkatëse. Fondi nuk ka bërë të ditur vlerat e drejta për pasuritë financiare dhe detyrimet financiare që nuk maten me vlerë të drejtë, sepse sasia e tyre mbartëse është një përafrim i arsyeshëm me vlerë të drejtë.

Fondi Raiffeisen Invest Eur

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

*(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***10. Të ardhura të ngjashme me të ardhurat nga interesat**

Të ardhurat nga interesat e instrumentave finaçiare sipas kategorisë përbehen si më poshtë :

	2024	2023
Obligacione të Qeverisë dhe korporatave	72,183	62,780
Të ardhurat nga interesi i depozitave	3,311	2,685
Totali i të ardhurave të ngjashme me të ardhurat nga interesat	75,494	65,466

Investimet ne obligacione kanë interesa nga 0.01% - 3.875% në vit për obligacionet e korporatave dhe nga 0 % - 5,75% për obligacionet e qeverive (2023 : interesat ishin nga 1.25% - 3.875% në vit për obligacionet e korporatave dhe nga 1.4% - 5.9% per obligacionet e qeverive).

11. Ndryshime të tjera në vlerën e drejtë të aktiveve finaçiare të mbajtura në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Ndryshimet në vlerën e drejtë detajohen si më poshtë :

	2024	2023
Fitime të realizuara nga investimet të matura me VDNFH	5,429	33,037
Fitime të parealizuara nga investimet të matura me VDNFH	384,000	404,830
Humbje të realizuara nga investimet te matura me VDNFH	(10,479)	(85)
Humbje të parealizuara nga investimet të matura me VDNFH	(295,821)	(284,178)
Ndryshimi total në vlerën e drejtë të aktiveve finaçiare	83,129	153,604

12. Humbje neto nga kursi i këmbimit

	2024	2023
Humbje të realizuara nga transaksionet e këmbimit valutor	(26,365)	(98,527)
Fitime /(humbje) të parealizuara nga transaksionet e këmbimit valutor	(167,087)	(217,249)
Totali	(193,452)	(315,775)

13. Aktive finaçiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Aktivet finaçiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes janë paraqitur si më poshtë :

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Obligacione Qeveritare dhe korporatash	2,684,635	2,295,063
Totali	2,684,635	2,295,063

Fondi Raiffeisen Invest Eur

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

14. Përfshirja me entitete të strukturuar të pakonsoliduara

Fondi ka arritur në përfundimin se fondet e palistuar të investimeve me fund të hapur në të cilat ajo investon, por që nuk konsolidohen, plotësojnë përkufizimin e entiteteve të strukturuar për shkak se:

- ✓ Të drejtat e votimit në fonde nuk janë të drejta dominuese për të vendosur se kush i kontrollon ato, sepse të drejtat kanë të bëjnë vetëm me detyra administrative;
- ✓ Aktivitetet e secilit fond janë të kufizuara nga prospektet e saj; dhe fondet kanë objektiva të ngushta dhe të përcaktuara mirë për të ofruar mundësi investimi për investitorët.

Bazuar në natyrën e këtyre investimeve, ekspozimi maksimal i Fondit ndaj humbjes është i barabartë me vlerën mbartës të investimit. Megjithatë, investimet e Fondit në këto entitete janë mbajtur kryesisht për të përputhur politikën e investimeve në prospekt dhe shumica e rrezikut nga një ndryshim në vlerën e investimit të Fondit përputhet me një ndryshim në politikën e investimit në prospekt.

Investimet në kuota përfshijnë investimet si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Kuota në fonde të tjera	1,081,545	844,003
Totali	1,081,545	844,003

Investimet në kuota përbëhen nga investimet si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
ACMBERNSTEIN-EUROP.INCOME	221,976	224,191
R 304 - EURO CORPORATES A	228,577	210,147
MSIF - Euro Corp. Bd- Dur. Hgd		98,149
RAIFF - NACHHALTIGKEIT-RENT VTA		209,787
RAIFFEISEN-EURO-RENDITE (I) A	161,124	101,730
R SHORTTERM RENT	164,423	
RAIFFEISENADDED VALUE 2027 III	68,884	
R EUROPA-HIGHYIELD	236,560	
Totali	1,081,545	844,003

Gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2024, Fondi nuk dha mbështetje financiare për njësitë e strukturuar të pakonsoliduara dhe nuk ka qëllim të japë mbështetjen financiare apo mbështetje të tjera. Fondi mund të shpengojë njësitë në fondet e mësipërme të investimit në çdo moment në kohë.

15. Mjete Monetare dhe Ekuivalente me to

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Llogaritë rrjedhëse me bankën kujdestare	17,322	12,337
Totali i llogarive rrjedhëse	17,322	12,337
Depozita në kosto të amortizuar	176,680	171,431
Totali i depozitave	176,680	171,431
Totali i parasë dhe ekuivalentë të saj	194,002	183,768

Fondi Raiffeisen Invest Eur

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

16. Detyrime të tjera

Detyrimet e tjera përfshijnë tatimin në burim mbi të ardhurat personale të mbajtur nga Shoqëria Administruese në lidhje me përfitimet kapitale nga tërhiqjet e kontributorëve gjatë muajit Dhjetor. Shoqëria Administruese vepron si agjent mbledhës për Fondin, sipas ligjit nr. 8438 “Tatimi mbi të ardhurat” i datës 28.12.1998.

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Detyrimet për organet tatimore	518	650
Tarifa e bankës depozitare	215	184
Tarifa rregullatore e pagueshme	167	143
Detyrime të tjera	989	1,047
Totali	1,888	2,024

17. Aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Aktive neto që i atribuohen kontribuesve më 1 janar	3,317,223	3,829,980
Kontributet e emetuara gjatë vitit	1,776,538	565,977
Kontribute të tërhequra gjatë vitit	(1,060,171)	(933,959)
	4,033,590	3,461,998
Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave gjatë vitit	(82,872)	(144,773)
Gjëndja më 31 dhjetor	3,950,718	3,317,225
Vlera e aktiveve neto për njësi në Lek më 31 dhjetor	11,303	11,584

18. Palët e lidhura

Palët konsiderohen si të lidhura në qoftë se njëra palë ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose të ushtrorë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operationale. Palët e lidhura të Fondit janë Raiffeisen INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a, e cila menaxhon Fondin, banka kujdestare e Fondit dhe Raiffeisen Bank sh.a. si aksionar i vetëm i shoqërisë administruese.

Që nga dhe për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 2023 Fondi ka hyrë në transaksionet dhe balancat e mëposhtme me palët e lidhura me të.

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Depozita		
Depozita në Raiffeisen Bank dhe Raiffeisen International	176,680	171,431
	176,680	171,431
Detyrime ndaj Shoqërisë Administruese		
Tarifë e pagueshme ndaj Shoqërisë administruese	(4,296)	(3,683)
	(4,296)	(3,683)
Të ardhura		
Të ardhura nga interesat e depozitave	3,311	2,685
	3,311	2,685
Shpenzime		
Tarifë e pagueshme ndaj Shoqërisë administruese	(45,239)	(44,962)
Totali	(45,239)	(44,962)

Fondi Raiffeisen Invest Eur

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

19. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit që mund të kërkojnë korrigjim ose rregullime shtesë në pasqyrat financiare.